

**AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“QUANTIC SOLUTION” SHPK**

Bazuar në vullnetin e ortakëve themelues dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011 vendoset si me poshtë:

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.

Neni 1:

Themelimi, Themeluesit, Emri.

Sot më datë 09.01.2025 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: “Quantic Solution” shpk. Themeluesi i shoqërisë “**Quantic Solution**” është Taulant Seferi, shtetas shqiptar, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 28.12.1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.039461326 dhe nr.personal: I61228074N., i cili redaktoi këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 2

Objekti i veprimtarise

Shërbime në fushën e teknologjisë së informacionit. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software, programim i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve.

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia e shoqërisë

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Selia e shoqërisë është në adresën: Njësia nr.7, Rruga “Muhamed Gjollesha”, Sheshi Karl Topia, Tirana Ring Center, Njesia X, Kuota +44.27, objekt me nr.pasurie 3/22, Zona Kadastrale 8210, Tiranë, Shqipëri”.

Kreu II

Kapitali i shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themelor i shoqërisë është caktuar në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon :

Lloji i kontributit është në para në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë si më poshtë;

- **Z. Taulant Seferi**, është zotëruar i 1 (një) Kuote, që i korrespondon 100 % (njëqind për qind) të Kapitalit të Shoqërisë.
- Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer dhe nënshkruar teresisht nga ortakët i shoqërisë.

Kreu III

Administratori i shoqërisë.



Neni 6
Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Adminstrator i shoqerise "Quantic Solution" sh.p.k. eshte Z. Taulant Seferi, shtetas shqiptar, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 28.12.1986, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me ID nr.039461326 dhe nr.personal: I61228074N.

Kreu IV
Dispozitat Përfundimtare.

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit tregtar.

Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Ky akt themelimi është përpiluar në tre kopje me vlerë të njëjta me origjinalin.

Tiranë, më datë 09.01.2025.

ORTAKU THEMELUES

TAULANT SEFERI

